



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT  
TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN  
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS**

Nr. 793/1 Prot.

Tiranë, më 16.02.2022

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1864, datë 01.08.2018.

**SHOQËRISË “NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE FIER” SH.P.K**

**Bashkia Fier**

**Për dijëni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE  
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA**

**Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.**

Shoqëria “NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE FIER” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1864, datë 01.08.2018, për mineralin Rërë Bituminoze, në objektin “Visokë”, Portez.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr.462, datë 25.01.2022, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr.793, Prot, datë 26.01.2022, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1864, datë 01.08.2018, për mineralin Rërë Bituminoze, në objektin “Visokë”, Portez pasi nuk ka respektuar kërkesat e legjislacionit minerar lidhur me pagesën e garancisë financiare të rehabilitimit për vitin 2021.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “ç” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit Nr.1864, datë 01.08.2018 për mineralin Rërë Bituminoze, në objektin “Visokë”, Portez, që shoqëria Juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1864, datë 01.08.2018 për mineralin Rërë Bituminoze, në objektin “Visokë”, Portez.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

**MINISTRI**  
**BELINDA BALLUKU**  
**ME AUTORIZIM**  
**ZËVENDËSMINISTRI**  
**ILIR BEJTJA**

